



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

PÛRKRAHJA E FERMERËVE NË PERIMTARI-SERRA - 2019

I. Qëllimi

Dhënia e mbështetjes financiare për investime në ferma, në kuadër të projekteve në sektorin agrorural, sipas Pasqyrës buxhetore për vitin vijues 2019 në fushën e perimekulturës.

II. Përfituesit e pranueshëm

Përfitues i pranueshëm_duhet të jetë personi fizik-fermer, të jetë banor i përhershëm i komunës së Prishtinës, si dhe prona të jetë në territorin e komunës së Prishtinës.

III. Lloji i investimeve të pranueshme për sektorin e perimekulturës

Ndërtimi i serrave të reja

- Tipi i serrës që mbështetet (përkrahet) është:

- serra e tipit “Tunel” nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m²,
- serra e tipit “Blok” nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m².

IV. Kriteret e përgjithshme të pranueshme:

- Përfituesi duhet të dorëzojë kërkesën e plotësuar në formularin për aplikim, së bashku me dokumentet e bashkangjitura;
- Përfituesi duhet të ketë të hapur llogari të vlefshme bankare;
- Toka në përdorim duhet të jetë në pronësi të aplikuesit. Në rast të fermave familjare, pronari i tokës mund të jetë fermeri ose të afërmit e tij/saj;
- Përparësi do të kenë fermerët e zonës ku është e zhvilluar perimekultura, përkatësishtë fermerët që kanë mundësi të ujitjes;

- Aplikuesi ose anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare të tij/saj (prind - fëmijë, burrë - grua), nuk mund të jenë përfitues nëse janë në marrëdhënie pune në institucionin që bën përkrahjen;
- Nëse janë plotësuar kriteret e kërkuara në mënyrë të barabartë, atëherë aplikohet parimi “I pari vjen i pari shërbehet”;
- Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore, së paku 1000 m² bllok në lokacionin ku ndërtohet serra;
- Përfituesi duhet të jetë banor i përhershëm në lokalitetin ku ngrihet serra;
- Përparësi do të kenë fermerët, të cilët nuk kanë fituar serra gjatë 3 vjetëve të fundit nga Komuna dhe donatorët e saj.

V. Kriteret specifike të serrës “Bllok” dhe “Tunel”, 500m²:

- Hapja e bazamentit Ø400*600, mbushje me beton dhe vendosja e gypit të zinkuar Ø60*2mm*600mm;
- Shtyllat duhet të jenë me material të zinkuar Ø60*2mm*2600mm;
- Harkoret me gypa të zinkuar Ø48*2mm*900mm;
- Pjesa e poshtme e kapriatit duhet të jetë me gypa të zinkuar Ø42*1.5mm*800mm;
- Mbushja e kapriatave me gypa të zinkuar Ø32*1.5mm*800mm;
- Përforcimi i serrës përgjatë tërë serrës me gypa të zinkuar Ø32*1.5mm*600mm, të gjitha kulmet duhet të kenë nga 3 gypa të vendosur, të shtanguara me unaza speciale, pa shpime dhe saldime;
- Ullukët e serrës duhet të jenë me material të zinkuar 13cm*12cm*13cm*1.6mm, me dhëmbë speciale për vendosjen e klipave të plastikës përgjatë tërë serrës, klipat duhet të jenë Ø16;
- Përforcimi i serrës anësore dhe shtangimi i folies duhet të bëhet me gypa të zinkuar Ø26*2mm*600mm. Për metër gjatësi të gypit duhet të vendosen 4-5 klipa ³/₄;
- Hapja e serrës duhet të bëhet me gypa të zinkuar Ø26*1.5mm*600mm, ku duhet të ketë të vendosur klipsa plastikë. Në një metër gjatësi, 4 copa klipa ³/₄;
- Gypat për përforcimin e dritareve me gypa Ø21*1.5mm*600mm;
- Serra duhet të jetë e rrethuar me polikarbon përgjatë gjithë serrës, me distancë 1 metër nga sipërfaqja e tokës, polikarboni 4-6mm. Polikarboni duhet të vendoset në dritare, ku bëhet edhe hapja;
- Duhet të vendosen dy dyer me polikarbon, me dimenssione 2.2m*2.4m. Konstruksioni i derës duhet të jetë me material të zinkuar dhe dera të jetë rrëshqitëse;
- Përforcimi i serrës duhet të bëhet me gypa Ø32*1.5mm*30mm, vendosja e gypave duhet të bëhet me unaza special, pa shpuarje. Një serrë duhet të ketë 9 përforcime X;
- Përforcimi i kulmeve, në fillim dhe në fund, duhet të bëhet me nga dy gypa Ø32*1.5mm*3m, të shtanguar me unaza speciale. Për të

përforcuar balloren, vendoset nga pjesa e poshtme e kapriatit dhe pjesa tjetër në harkore;

- Folia duhet të jetë UV, antirefleks, antipik, me një trashësi 160mm, me garanci për 36 muaj;
- Lidhja e gypave duhet të bëhet me vazhduese special, pa saldim;
- Unazat për shtangimin e të gjitha gypave me harkoret, duhet të bëhet me kundërlidhëse, me nga 4 bulona për secilën lidhje;
- Unazat për lidhjen e kapriatave me harkore duhet të jenë 4cm/1.2mm;
- Lidhja e kapriateve duhet të bëhet me Y- ypsilon, me dy anësore, me një trashësi 1.6mm, shtangimi duhet të bëhet me bulona;
- Puna duhet të kryhet nga një kompani, e cila ofron garanci për ndërtimin e serrës dhe mban përgjegjësi për të gjitha punët e kryera. Në rast të mospranimit të serrës nga komisioni për defekte të ndryshme ose mospërputhja e materialit gjatë ndërtimit të serrës gjatë vizitës së komisionit për pranim, ndërtuesi duhet të kompensojë fermerin me kthimin e mjeteve.

VREJTJE: Në rast të mospërputhjes së materialit dhe ndërtimit të serrës sipas specifikave të parapara, fermeri nuk do të kompensohet për investimin e realizuar.

Gjatë punës, kompania duhet të pranojë komisionin e Komunës gjatë realizimit të punëve, dhe komisioni do të verifikojë materialin gjatë investimit. Komisioni do të vizitojë fermerët gjatë investimit, sipas përzgjedhjes, pa e njoftuar fermerin.

VI. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve:

1. Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim, është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim;
2. Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë nga data e publikimit;
3. Investimi duhet të kryhet në afat prej 60 ditëve nga data e miratimit të projektit, dhe të gjitha pagesat duhet të bëhen përmes transferit bankar.

VII. Përzgjedhja dhe pagesat

I. Mënyra e përzgjedhjes:

1. Aplikacionet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen në afatit prej 15 ditëve, nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim;
2. Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë, verifikohet aplikacioni në terren;
3. Përfituesi obligohet që para fillimit të investimeve, t'i dorëzojë 3 oferta rreth kostos për finalizimin e projektit (serrës);

4. Përfituesi do të pranojë një letër njoftuese për miratimin apo refuzimin e projektit (së bashku me arsyetimin);
5. Pas sjelljes së ofertave, përfituesi do të njoftohet rreth vlerës financiare që do të përkrahet nga ana e Komunës;
6. Përfituesi duhet menjëherë të informojë për fillimin e investimit;
7. Komuna e Prishtinës do të lidhë marrëveshje me përfituesin e serrës, i cili obligohet që të mos e bëjë tjetërsimin e serrës (shitje, dhënie në shfrytëzim etj.) në afat kohor brenda 5 vjetëve.

II. Mënyra e pagesave:

Komuna participon 80% në realizimin e projekteve dhe pjesën tjetër, prej 20%, do të participojë fermeri për ngritjen e serrës, me sipërfaqe 500m², në vlerën e përgjithshme.

Pagesat do bëhen pas vlerësimit të zyrtarëve të autorizuar për kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe investimeve të planifikuara.

Rimburesimi i mjeteve do të bëhet pasi të jetë vlerësuar nga autoriteti përkatës për realizimin e investimeve të planifikuara.

VII. Dokumentet e bashkëngjitura:

- Projektpropozimi me përshkrim të hollësishëm;
- Përshkrimi i gjendjes në fermë;
- Qëllimi i investimeve;
- Kosto e investimeve;
- Fotokopja e letërnjoftimit;
- Konfirmimin për llogarinë bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e tokës së punueshme, jo më e vjetër se një vit;
- Kopja e planit të parcelës;
- Vërtetim mbi vendbanimin;
- Deklaratë e bashkësisë familjare.

Data e aplikimit: 31.10.2019 – 14.11.2019